



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	65
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	08.05.2017
Prishtinë / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/65/2017

Datë: 05/05/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit nr. 05/L-095 për, Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e dytë të përbërjes së parë, të mbajtur më 05 maj 2017, mori këtë:

**V E N D I M**

**Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Drejtues të mbajtur më 03 prill 2017**

1. Miratohet procesverbali i takimit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i datës 03 prill 2017.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

*A. Lumezi*

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	67
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	08.05.2017
Prishtinë / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/67/2017  
Datë: 05/05/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 4 dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e dytë të përbërjes së parë, të mbajtur më 05 maj 2017, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Logoja e Akademisë së Drejtësisë.
2. Logoja e Akademisë së Drejtësisë duhet të përdoret në të gjitha shkresat, ambientet dhe format tjera të përfaqësimit të Akademisë së Drejtësisë, konform dispozitave ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

*A. Lumezi*

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	66
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	08.05.2017
Prishtinë / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademia Pravde/ Academy of Justice*

Nr. 01/66/2017  
Datë: 05/05/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e dytë të përbërjes së parë, të mbajtur më 05 maj 2017, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Rregullorja për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

*A. Lumezi*

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Drejtorit të Akademisë së Drejtësisë  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademia Pravde/Academy of Justice*

---

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në mbështetje të nenit 10 paragrafit 1, nën paragrafët 1.1, 1.7 dhe nenit 18 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 05.05.2017, miraton këtë:

**RREGULLORE NR. 01/2017**

**PËR PROCEDURËN E EMËRIMIT DHE SHKARKIMIT TË DREJTORIT  
EKZEKUTIV TË AKADEMISË SË DREJTËSISË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton procedurën e përzgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet nga Akademia e Drejtësisë për qëllimet e përcaktuara me këtë rregullore.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Për qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
  - 1.1 “Këshilli” nënkupton Këshillin Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
  - 1.2 “Drejtori” nënkupton Drejtorin Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
  - 1.3 “Komisioni” nënkupton Komisionin për Përzgjedhjen e Drejtorit i emëruar nga Këshilli Drejtues i Akademisë;
  - 1.4 “Komisioni Disiplinor” nënkupton Komisionin Disiplinor të formuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë;

## **Neni 4**

### **Parimet e emërimit të drejtorit**

Emërimi i drejtorit bëhet duke u bazuar në parimin e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanshmërisë.

## **Neni 5**

### **Kushtet për zgjedhjen e Drejtorit**

1. Për t'u emëruar Drejtor, kandidati duhet t'i plotësoj kushtet si në vijim:
  - 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
  - 1.2. të ketë diplomë universitare në fushën e drejtësisë, të vlefshme në Republikën e Kosovës;
  - 1.3. të ketë të dhënë provimin e jurisprudencës;
  - 1.4. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;
  - 1.5. të ketë punuar si gjyqtarë, apo prokurorë për së paku pesë (5) vite, apo të ketë tetë (8) vite përvojë pune, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë menaxheriale;
  - 1.6. të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale
  
2. Gjatë vlerësimit të kandidatëve, Komisioni përveç kushteve të përcaktuara me ligj vlerëson edhe kriteret si në vijim:
  - 1.1 Kualifikimet profesionale për kryerjen e funksionit, përfshirë trajnimet përkatëse;
  - 1.2 Aftësitë dhe njohuritë në kryerjen e punëve të udhëheqjes dhe organizimit;
  - 1.3 Aftësitë e komunikimit, përfshirë njohjen e gjuhëve të huaja;
  - 1.4 Gatishmërinë për bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera;
  - 1.5 Vlerësimin paraprak të performancës në punë;
  - 1.6 Integritetin personal;
  
3. Vlerësimi i kriterëve nga paragrafi 2 i këtij neni bëhet përmes dokumentacionit, intervistës me kandidatin dhe referencave.

## **Neni 6**

### **Procedura e rekrutimit**

1. Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, merr vendimin për fillimin e procedurës së rekrutimit të Drejtorit, dhe autorizon shpalljen e konkursit publik.
2. Kryesuesi i Këshillit njofton Ministrinë e Administratës Publike për fillimin e procedurës së rekrutimit të Drejtorit.
3. Procedura e rekrutimit zhvillohet nga Komisioni për Përzgjedhjen e Drejtorit, në mbështetje të administratës së Akademisë.

## **Neni 7**

### **Komisioni Përzgjedhës**

1. Komisioni formohet nga Këshilli, dhe ka në përbërje 5 anëtarë, si në vijim:
  - 1.1. Dy (2) nga radha e Këshillit Drejtues të Akademisë;
  - 1.2. Një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore;
  - 1.3. Një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore;
  - 1.4. Një (1) përfaqësues nga shoqëria civile.
2. Anëtarët e Komisionit Përzgjedhës nuk mund të jenë më shumë se dy herë radhazi anëtar të Komisionit.
3. Përfaqësuesi i shoqërisë civile duhet të jetë person me pozitë udhëheqëse në një organizatë të shoqërisë civile dhe të njihet për integritetin e tij/saj dhe gjykimin e drejtë.
4. Komisioni është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjes së listës së ngushtë, intervistimin, vlerësimin e kandidatëve dhe propozimin e listës përfundimtare të kandidatëve.
5. Komisioni ka mandat vetëm për zhvillimin e një procedure të rekrutimit dhe shpërbëhet me përfundimin e kësaj procedure, me përjashtim të rasteve kur procedura e rekrutimit duhet të përsëritet për shkak të pranimit të një numri të pamjaftueshëm të aplikacioneve.

## **Neni 8**

### **Mbështetja administrative**

1. Administrata e Akademisë ofron mbështetje administrative në procesin e emërimit të Drejtorit dhe është përgjegjëse për çështjet në vijim:
  - 1.1 të informojë çdo aplikant me shkrim lidhur me vendimet e Komisionit, mbi statusin e përfshirjes së tyre në listën e kandidatëve potencial;
  - 1.2 të ofroj mbështetje administrative për Komisionin, në planifikimin e punës së tyre dhe këshillimin e anëtarëve për zbatimin e procedurave;
  - 1.3 të siguroj që anëtarët e Komisionit t'i marrin me kohë informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve;
  - 1.4 të mbaj regjistrin e aplikacioneve me dokumentet përcjellëse për secilin aplikant, sipas procedurave të përcaktuara për shërbimin civil;
  - 1.5 të siguroj informata, me kërkesën e Komisionit, lidhur me kandidatët e përfshirë në listë, me qëllim të sigurimit të integritetit dhe transparencës së procesit;
  - 1.6 të siguroj respektimin e konfidencialitetit të procesit;

## **Neni 9**

### **Konkursi publik**

1. Akademia do të shpallë konkursin publik për pozitën e Drejtorit, i cili do të jetë i hapur së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e shpalljes në gazeta.

2. Konkursi publik duhet të përmbajë, së paku;
  - 2.1 emrin e institucionit i cili bën shpalljen publike,
  - 2.2 titullin e vendit të punës dhe referencën,
  - 2.3 kategorinë funksionale dhe gradën e pozitës,
  - 2.4 përshkrimin e detyrave të punës, detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës,
  - 2.5 kriteret dhe kualifikimet e nevojshme për vendin e punës,
  - 2.6 kohëzgjatjen e emërimit,
  - 2.7 vendin dhe mënyrën e marrjes dhe dorëzimit të aplikacionit,
  - 2.8 datën e mbylljes së konkursit, dhe
  - 2.9 dokumentet e nevojshme që duhet të dorëzohen me aplikacion,
  - 2.10 kërkesat tjera të nevojshme siç është përcaktuar me ligj dhe rregullore për rekrutimin në shërbimin civil.
3. Konkursi shpallet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës në së paku 3 gazeta ditore, web faqen e Akademisë së Drejtësisë dhe duhet të jetë lehtë i qasshëm për të gjithë të interesuarit.
4. Konkursi publik duhet të shpallet brenda 7 ditëve të punës pas miratimit nga Këshilli.

## **Neni 10**

### **Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve**

1. Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve për pozitën e shpallur të Drejtorit, bëhet sipas informatave të dhëna në konkurs.
2. Kandidatët të cilët konkurrojnë për pozitën e Drejtorit, duhet të plotësojnë aplikacionin në njërën nga gjuhët zyrtare.
3. Aplikacionet e dërguara jashtë afatit të përcaktuar në konkurs nuk merren në konsideratë me përjashtim të aplikacioneve të dërguara me postë, nëse data në dërgesën postare dëshmon se ajo është dërguar brenda afatit të përcaktuar me konkurs.
4. Nëse pas kalimit të afatit të përcaktuar për pranimin e aplikacioneve nuk është arritur numri i së paku pesë (5) aplikacioneve të pranuar, si dhe nuk janë pranuar aplikacione për balancimin gjinor dhe etnik, zgjatet afati për dorëzimin e aplikacioneve edhe për 7 ditë të tjera.
5. Nëse edhe pas kalimit të afatit nga paragrafi 4 i këtij neni, nuk pranohen së paku pesë (5) aplikacione, procedura e rekrutimit ndërpritet nga administrata e Akademisë dhe njoftohet Këshilli, i cili mund të marrë vendimin që të publikohet konkursi i ri për rekrutimit e drejtorit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin për shërbyesit civil dhe këtë rregullore.
6. Në rast të ri shpalljes së konkursit të ri sipas paragrafit 5 të këtij neni, Komisioni do të procedoj me vlerësimin e kandidatëve që kanë aplikuar, pavarësisht numrit të aplikantëve.

## **Neni 11**

### **Procedura e përzgjedhjes**

1. Pas mbylljes së konkursit, brenda pesë (5) ditëve, administrata e Akademisë, krijon një regjistër të aplikacioneve të pranuar me të dhënat e nevojshme dhe këtë regjistër së bashku me dosjet e kandidatëve ia dorëzon Komisionit, për të zhvilluar procesin e rekrutimit.
2. Komisioni brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i dosjeve, shqyrton aplikacionet dhe dosjet e kandidatëve, si dhe përgatitë një listë të ngushtë të kandidatëve në bazë të profilit, meritës dhe përshtatshmërisë së tyre me kriteret e përcaktuara me ligj për pozitën e Drejtorit.
3. Për përgatitjen e listës së ngushtë Komisioni duhet të verifikojë:
  - 3.1 përmbushjen e kriterëve formale të përcaktuara me ligj;
  - 3.2 dokumentet përkatëse që dëshmojnë kualifikimin e tyre;
  - 3.3 verifikojë përvojën e kandidatëve;
  - 3.4 ekzistimin ose jo të dosjes penale;
4. Nëse Komisioni nuk gjen së paku 3 kandidatë për listën e ngushtë, atëherë duhet të përgatisë një raport për Këshillin, me rekomandimin për anulimin e procesit të rekrutimit dhe fillimin e procesit nga e para, me përjashtim të rastit nga paragrafi 6 i nenit 10 të kësaj rregulloreje. Këshilli merr vendim për shpalljen e procesit të rekrutimit, bazuar në raportin e Komisionit.
5. Kandidatët të cilët janë përzgjedhur në listën e ngushtë, njoftohen brenda pesë (5) ditëve, nga dita e përpilimit të listës së ngushtë nga ana e administratës dhe njëkohësisht edhe ftohen të marrin pjesë në intervistë.

## **Neni 12**

### **Intervistimi i kandidatëve**

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbyesit civil, Komisioni zhvillon intervistën me kandidatë brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga dita e njoftimit të kandidatëve. Komisioni është përgjegjës për përgatitjen e pyetjeve që do t'iu parashtrihen kandidatëve, dhe për sistemin e vlerësimit në pajtim me legjislacionin në fuqi për shërbyesit civil.
2. Secili anëtarë i Komisionit bën vlerësimin e secilit kandidatë në mënyrë të pavarur, dhe nënshkruan formularin përkatës i cili i është bashkëngjitur kësaj rregullore.
3. Në përfundim të intervistës, Kryetari i Komisionit shënon të gjitha pikët e anëtarëve të Komisionit në formularin përfundimtarë të vlerësimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Pikët totale në bazë të intervistës nxirren duke përlogaritur mesataren e pikëve nga secili anëtar i Komisionit.

## **Neni 13**

### **Njoftimi i rezultateve**

1. Komisioni brenda afatit prej shtatë (7) ditëve pas përfundimit të vlerësimit të kandidatëve, do të përgatit raportin përfundimtarë, dhe Këshilli Drejtues do t'ia rekomandoj për emërim tre (3) kandidatët që kanë marrë pikët më të larta gjatë këtij procesi, me përjashtim të rastit nga paragrafi 6 i nenit 10 të kësaj rregulloreje.



2. Komisioni brenda afatit të përcaktuar nga paragrafi 1 i këtij neni, i dërgon formularin përfundimtarë të kandidatëve dhe e autorizon administratën e Akademisë që t'i njoftojë të gjithë kandidatët me rezultatet individuale.

#### **Neni 14**

##### **Ankesat për procedurën e rekrutimit**

1. Kandidatët e pakënaqur me refuzimin e aplikacionit apo me procedurën e vlerësimit të Komisionit, mund t'i paraqesin ankesë me shkrim Këshillit, brenda afatit prej 5 ditësh nga dita e publikimit të rezultateve.
2. Kundër vendimit të Këshillit, kandidati i pakënaqur mund të paraqesë ankesë pranë organeve kompetente. Ankesa kundër vendimit të Këshillit nuk e pengon emërimin e Drejtorit.

#### **Neni 15**

##### **Zgjedhja dhe emërimi**

1. Këshilli Drejtues në bazë të raportit të Komisionit, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, vendos për emërimin e njërit prej tre (3) kandidatëve, me përjashtim të rastit nga paragrafi 6 i nenit 10 të kësaj rregulloreje, të rekomanduar për emërim në pozitën e Drejtorit.
2. Votimi bëhet fillimisht për kandidatin e parë në listën e propozuar nga Komisioni, nëse kandidati i parë nuk merr numrin e mjaftueshëm të votave nga numri i anëtarëve të përgjithshëm të Këshillit, procedohet me votim për kandidatin e dytë, dhe nëse kandidati i dytë nuk merr numrin e nevojshëm të votave, vazhdohet me kandidatin e tretë. Në rast se asnjë kandidat nuk merr shumicën e votave atëherë konkursi shpallet nga fillimi.
3. Kohëzgjatja e mandatit të Drejtorit është tre (3) vjet, siç përcaktohet me nenin 15 të Ligjit për Shërbimin Civil, si dhe nenit 14 të Rregullores për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil. Nëse pas tri (3) vitesh Këshilli e konsideron të kënaqshme performancën e Drejtorit, atëherë vendos me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve për vazhdimin e mandatit të Drejtorit.
4. Nënshkrimi i Aktit të Emërimit për pozitën e Drejtorit, bëhet nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues, pas kalimit të afatit të përcaktuar për ankesë.

#### **Neni 16**

##### **Përfundimi i marrëdhënies së punës**

1. Marrëdhënia e punës së Drejtorit përfundon me:
  - 1.1 shqiptimin e dënimit për veprë penale me vendim të formës së prerë;
  - 1.2 shkarkimin nga Këshilli;
  - 1.3 dorëheqje;

- 1.4 dështimin e përmbushjes së detyrave të punës;
  - 1.5 shpalljen e paaftësisë së përhershme për ushtrimin e detyrës zyrtare për arsye shëndetësore;
  - 1.6 arritjen e moshës së pensionimit;
  - 1.7 vdekje.
2. Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga paragrafi 1.2 dhe 1.4 të këtij neni e merr Këshilli me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

### **Neni 17**

#### **Shkarkimi i Drejtorit**

1. Drejtori shkarkohet nga Këshilli, nëse konstatohet se:
  - 1.1. i është shqiptuar dënimi për vepër penale me vendim të formës së prerë;
  - 1.2. ka dështuar në përmbushjen e detyrave në bazë të vlerësimit të detyrave të punës;
  - 1.3 i është shpallur paaftësia e përhershme për ushtrimin e detyrës zyrtare për arsye shëndetësore;
  - 1.4 është rekomanduar nga Komisioni Disiplinor, për shkak të shkeljeve të rregullave të sjelljes dhe disiplinës;
2. Për qëllim të zbatimit të pikës 2, paragrafi 1 të këtij neni, vlerësimin e përmbushjes së detyrave e kryen Kryetari i Këshillit Drejtues, përshtatshëm sipas dispozitave përkatëse për nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues.
3. Procedura e shkarkimit të Drejtorit mund të iniciohet nga Kryesuesi dhe 1/3 e anëtarëve të Këshillit Drejtues, me kërkesë të shkruar që i dorëzohet Kryesuesit të Këshillit Drejtues në të cilën përshkruhet baza për shkarkim.
4. Dokumentet që përmbajnë çfarëdo fakti të rëndësishëm, duhet t'i bashkëngjiten propozimit për shkarkim.
5. Anëtarët e Këshillit Drejtues mbajnë takim të mbyllur për të diskutuar shkarkimin e propozuar. Drejtori i propozuar për shkarkim ka të drejtë të jetë i pranishëm në takim dhe ka të drejtë të përgjigjet ndaj propozimit për shkarkim, të japë ose të paraqesë shpjegime ose informacione dhe t'u përgjigjet pyetjeve të anëtarëve.
6. Vendimi i Këshillit Drejtues për shkarkim duhet të jetë me shkrim dhe të përmbajë arsyetimin.
7. Ndaj vendimit për shkarkim mund të hapet konflikt administrativ në përputhje me ligjin.

### **Neni 18**

#### **Procedura disiplinore**

1. Në rast se paraqitet pretendimet për shkelje disiplinore nga Drejtori, Këshilli formon një komision disiplinor për të trajtuar shkeljet eventuale.
2. Komisioni disiplinor përbehet nga një (1) anëtar i Këshillit Drejtues, një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror.

3. Komisioni disiplinor pas vlerësimit të pretendimeve të paraqitura për shkelje, i paraqet Këshillit Drejtues raportin me rekomandimet për shqiptimin masës siç e përcakton legjislacioni për shërbimin civil.

### **Neni 19**

#### **Suspendimi i Drejtorit**

1. Këshilli mund ta suspendojë Drejtorin me pagesë në lartësinë siç është përcaktuar me Ligjin për Shërbimin Civil, në rast se ndaj tij ngritët aktakuzë, i caktohet paraburgimi apo për shkelje të rëndë të detyrave të punës.
2. Suspendimi i Drejtorit zgjatë deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Këshilli.

### **Neni 20**

#### **Dispozitat përfundimtare**

1. Për të gjitha çështjet tjera që nuk janë rregulluar me këtë rregullore, përshtatshmërisht do të zbatohet legjislacioni në fuqi për Shërbimin Civil të Kosovës.
2. Bashkëngjitur me këtë rregullore janë formularët për vlerësimin e kandidatëve.

### **Neni 21**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli.

Prishtinë, 05.05.2017



Aleksandër Lumezi

*A. Lumezi*

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë